

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjedhjet në Gjermani/ Goditet CDU e Merz, AfD merr një tjetër fitore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zgjedhjet-ne-gjermani-goditet-cdu-e-merz-afd-merr-nje-tjeter-fitore-i587319
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 16:49:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 17:20:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d18cff4f93c4ca84028a21a905831e1d12eb7ebe87acbfd5fc6019e0f25960a7
TEKSTI	ab3ae52a0ab004cce8d96367e3d661f7dd8dcd661314a82eb3ee2c0370e96baa
PAMJA	0e214f24d333fb00e4c274b00a25c4f1b19ba7130ab37d5f46b6880888d7e171

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	418670a0609391541667faff23b140c8142c70bd7b2e77a4be90c9c35ef62aa6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/418670a0609391541667faff23b140c8142c70bd7b2e77a4be90c9c35ef62aa6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Retuzoi Shqiperine dhe mori ftesen e pare nga Gjermania, Brajan Gruda demtohet pak dite para grumbullimit me "Panzerat" Ukraina sulmon per here te pare Rusine me fundit](#)

Zgjedhjet në Gjermani/ Goditet CDU e Merz, AfD merr një tjetër fitore



20 Shtator 2026, 19:20Bota TEMA



Rezultate të vështira për partinë e kancelarit gjerman Friedrich Merz në dy zgjedhje rajonale në Gjermani.

Sondazhet në dalje të votimit tregojnë humbje të ndjeshme për CDU-në, ndërsa AfD forcon pozitat në lindje të vendit dhe e majta del në avantazh në Berlin.

Në Mecklenburg-Vorpommern, AfD rezulton forcë e parë me rreth 37% të votave, sipas exit poll-it të transmetuesit publik ARD. Social Demokratët e SPD-së ndjekin shumë pranë me 35.5%.

CDU e kancelarit Merz përllogaritet me vetëm 5.5%, rezultat që do të ishte më i dobëti i saj në një zgjedhje rajonale që prej vitit 1949. Me pragun elektoral prej 5%, mbetet ende për t'u parë nëse CDU do të sigurojë mandate në parlamentin e landit.

Rezultati i Mecklenburg-Vorpommern është veçanërisht domethënës për AfD-në, e cila ka shënuar rritje të fortë në zgjedhjet e fundit në landet lindore.

Megjithatë, edhe nëse AfD përfundon forcë e parë, partitë e tjera kanë deklaruar se nuk do të formojnë koalicion me të, çka e bën të pasigurt mundësinë e saj për të marrë drejtimin e qeverisë së landit.

Në zgjedhjet në Berlin, Die Linke del në krye me rreth 24.5%, ndërsa CDU renditet e dyta me rreth 20%, sipas exit poll-it të ARD.

Rezultatet e dy zgjedhjeve po ndiqen me vëmendje në Berlin, pasi konsiderohen edhe si një test i rëndësishëm për qeverinë federale dhe drejtimin e CDU-së nën Friedrich Merz.

Për kancelarin Merz, rezultatet vijnë në një moment kur AfD po konsolidon mbështetjen në disa zona të Gjermanisë, ndërsa CDU po përballlet me presion të shtuar politik pas rezultateve të dobëta në zgjedhjet rajonale.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ukraina sulmon për herë të parë Rusinë me raketa balistike, Zelensky: Goditëm objektet e industrisë së naftës](#)

18:30 Bota

Sllovakia "sulmon" BE, kryeministri Fico: Disa liderë perëndimorë duan patjetër luftë me Rusinë

18:20 Bota

Trump ndryshon projektin e Harkut të Triumfit: Do të shërbejë edhe si kompleks ushtarak

17:50 Bota

"Nuk jemi në luftë me Huthët" - Tajani, pas goditjes së avionit italian: BE duhet të forcojë misionin në Detin e Kuq

17:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.